



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL
DREJTORI EKZEKUTIV

Nr. 920/prot.
1

Tiranë, më 25.06.2020

VENDIM

Nr. 26, datë 25.06.2020

**PËR DHËNIEN E PËRJASHTIMIT PËR TRANSPORTIN E MALLRAVE
NË KABINËN E PASAGJERËVE GJATË PANDEMISË COVID-19**

Në mbështetje të nenit 13, pika g, të Ligjit Nr. 10 233, datë 11.2.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, i ndryshuar, dhe në zbatim të Ligjit Nr. 10040 “Për Kodin Ajror të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Nenit 14 të Urdhërit të Ministrit Nr.3, datë 07.02.2011 “Për Rregullat e Përbashkëta në Fushën e Aviacionit Civil, i ndryshuar”, Vendimin e AAC Nr.23 datë 12.06.2020 “Manuali Udhëzues për Transportin e Ngarkesave në Kabinën e Pasagjerëve”, datë duke analizuar rrethanat dhe situatën e krijuar nga pandemia e Covid-19:

V E N D O S A:

1. Dhënie e përjashtimit “Për transportin e mallrave në kabinën e pasagjerëve gjatë pandemisë COVID-19” deri në 31 Tetor 2020, nga paragrafet e CAT.IDE.A.100, CAT.OP.MPA.160 të Urdhërit të Ministrit Nr. 59/2020, 21.A.181 të Urdhërit të Ministrit Nr. 326/2019, M.A.304, M.A.501 M.A.902(b)(2) dhe M.A.902(b)(5) të Urdhërit të Ministrit Nr. 167/2020 për komponentët/pjesët që kanë të bëjnë me fiksimin/sigurinë e mallrave gjatë transportit në kabinë dhe modifikimi/riparimi i tyre.
2. Ky përjashtim zbatohet për “Air Albania” sh.p.k
3. Ky përjashtim është subjekt i kushteve të:
 - Zbatimit të Vendimit të AAC Nr.23, datë 12.06.2020, “Manuali Udhëzues për Transportin e Ngarkesave në Kabinën e Pasagjerëve”
 - Zbatimit të masave mitiguese të nxjerra nga operatori dhe të pranuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil;
 - “Air Albania” sh.p.k. do të njoftojë Autoritetin e Aviacionit Civil të paktën 48 orë përpara nisjes/uljes në Aeroportin “Nënë Tereza”
5. Ky përjashtim është në fuqi deri në datë 31.10.2020 në 23:59 EST.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR EKZEKUTIV

Edlira Kraja

